



Unioni i Shkollave të Mesme të Larta të Mjekësisë - Kosovë
Union of High Schools of Medicine - Kosovo

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional

STANDARDI I PROFESIONIT

Profili arsimor: Teknik i Farmacisë
niveli 4-të KKK

Lëmia: Shëndetësi

Kodi: 3213 - Teknik i Farmacisë

Sipas librit të klasifikimit të profesioneve në Kosovë



Unioni i Shkollave të Mesme të Larta të Mjekësisë - Kosovë
Union of High Schools of Medicine - Kosovo

Ekipi i zhvillimit:

1. Mr. Ph. Granit Çeku
2. Mr. Ph. Kushtrim Nikqi
3. Mr. Ph. Xhevat Sejdiu
4. Diellza Keka, farmacistë bachelor

Koordinatorë i ekipit: Riza Haxhiu

Ekipi verifikues: _____

Data e aprovimit : ____ / ____/20____

Valide prej : ____ / ____/20____

Përshkrimi i profesionit:

Teknik i Farmacisë është pjesë e ekipit të Farmacistëve që ndihmon farmacistin gjatë procedurës terapeutike në sektorin e farmacisë. Përgatit vendin e punës, materialet, instrumentet dhe pajisjet për procedurat terapeutike në sektorin e farmacisë. Mbart shënime dhe regjistron të dhënat mjekësore në pajtim me rregullat ligjore.

Profesioni Teknik i Farmacisë është një profesion që ka të bëjë me mbarrëvajtjen e prodhimit të mirëfilltë të prodhimit të barnave, ku roli i teknikut zë një vend të rëndësishëm para, gjatë, dhe pas procesit të prodhimit duke ndihmuar në aspektin teknik udhëheqësit e sektorëve gjegjëse të prodhimit. Përgatitja profesionale e teknikut të farmacisë në prodhim konsiston në faktin se kjo detyrë është më përgjegjësi dhe mjaft specifike duke pasur parasysh avancimin gjithnjë e më shumë të teknologjisë farmaceutike

Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave përdor teknologjinë moderne të informacionit dhe komunikimit. Komunikon me përdoruesin (pacientin) e shërbimeve farmaceutike-mjekësore, duke respektuar dinjitetin njerëzor, diversitetin kulturor, fetar, moshën, gjendjen sociale dhe ekonomike. Punon në mbikëqyrjen e farmacistit dhe me ekipin e farmacistëve gjatë zbatimit të procedurave terapeutike. Punon në përputhje me standardet e pranuar, rregulloret ligjore dhe etikën profesionale. Merr pjesë në edukimin e përdoruesve (pacienteve) për bazat e higjienës dhe parandalimin e sëmundjeve infektive.

Tekniku i Farmacisë, pas përfundimit të shkollimit të tre vjeçar duhet të jetë i aftë të ushtrojë këto kompetenca profesionale:

- Përgatit vendin e punës.
- Përzgjedh veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punë.
- Respekton standardet e profesionit.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit dhe etikën mjekësore.
- Lexon dhe interpreton recetën mjekësore;
- Matë, grimcon, tretë, filtron dhe paketon medikamente.
- Përgatit yndyra të ndryshme, tretësira, pluhura dhe forma të tjera galenike në baze të recetës mjekësore, në mënyrë të pavarur;
- Kryen punët administrative laboratorike;
- Dallon preparatet e ndryshme farmaceutike dhe mënyrën e administrimit;
- Aftësohet në manipulimin me pajisjet laboratorike;
- Përzgjedh pajisjet, mjetet e punës dhe materialet e duhura për përgatitjet galenike dhe ofciale;
- Përdor dhe mirëmban pajisjet laboratorike

Krahas këtyre kompetencave profesionale të cekura më lart nxënësi duhet të jetë i aftë të ushtroj edhe këto kompetenca të përgjithshme profesionale:

- Përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Manifestojë qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Nxitë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive dhe më eficientë.
- Respekton rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe globale.
- Manifeston guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Tregon vetëkontroll në ushtrimin e veprimtarive të tij në kontekstin e pavarësisë në vendimmarrje.
- Organizon drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.

- Hulumton vetveten dhe rrugët e mundshme të karrierës profesionale për të bërë zgjedhje të përshtatshme të veprimtarive profesionale.

Puna e Teknikut të Farmacisë në ekip është i bazuar në profesionalizëm, përgjegjësinë për zbatimin e masave të kujdesit shëndetësor në mjekësin farmaceutike (në përputhje me standardet, vlerësimin dhe respektin për të gjithë anëtarët e ekipit dhe pacientet) si dhe zbatimin konsekuent të rregullave ligjore dhe parimet etike në praktikën e përditshme. Me qëllim të përmirësimit të shëndetit të individëve dhe komuniteteve, bashkëpunon me profesionistë të tjerë: punonjës socialë, psikologë, teologë, defektolog – rehabilitues, logoped, pedagog etj.

Tekniku i Farmacisë zakonisht punon në fabrikat e prodhimit të ilaçeve dhe barnave, klinika mjekësore, laboratorë të farmacisë në klinika dhe barnatore.

Tekniku i Farmacisë gjatë orarit të punës përdori veshje , këpucë dhe pajisje të tjera mbrojtëse sipas etikes së personelit mjekësor. Orari i punës varet nga institucioni ku punon.

Qëndrimi i dëshiruar ndaj punës:

Tekniku i Farmacisë duhet të:

- Komunikoj në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet, ndjenjat e tij dhe për të argumentuar mendimet për çështje të ndryshme;
- Angazhohet fizikisht dhe mentalisht në zgjidhjen e situatave të ndryshme që do të ndeshë në kontestin profesional, personal dhe shoqëror;
- Respektoj parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar,
- Vlerësoj dhe të vetë vlerësojë nisur nga kriteret e drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet.

Forma tabelore e Funksioneve dhe përshkrimi i funksionit për profilin arsimor – Teknik i Farmacisë

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punëve dhe detyrave	Analizon procedurat profesionale të punëve dhe detyrave Merr pjesë në planifikimin, programimin dhe organizimin e punëve dhe detyrave
2	Përgatitja e vendit të punës	Merr pjesë në sigurimin e kushteve hapësinore Përgatit aparaturën dhe aksesoret për prodhimin e barnave nën mbikëqyrjen e farmacistit Përgatitja dhe monitorimi i punës sterile
3	Pranon dhe deponon barna dhe substanca farmaceutike në barnatore dhe depo farmaceutike	Merr pjesë në pranimin cilësor dhe sasior të lëndës së parë, substancave farmaceutike, substancave ndihmëse, barnave, drogës, materialit sanitar, ambalazhit, etj. dhe kryen deponimin e tyre Kontrollon dhe evidenton barnat, drogat, substancat shëruese dhe ndihmëse, ambalazhin dhe materialin sanitar. Selekton (bën renditjen) e barnave, drogat, substancat farmaceutike, preparatet kozmetike sipas radhitjes alfabetike, veçorive (veprimet farmakologjik), gjendjes agregate (konsistencës), mënyrës së aplikimit dhe destinimit
4	Përgatit barna magjistrale dhe përgatesa galenike	Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave të lëngëta farmaceutike Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave të buta farmaceutike Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave gjysmë të ngurta dhe të ngurta farmaceutike Merr pjesë në prodhimin e barnave magjistrale dhe galenike të cilat në vetë nuk përmbajnë substanca të ndikimit të fortë dhe shumë të fortë dhe narkotikë
5	Kryen dhe mbikëqyr fazat teknologjike në prodhimtarinë farmaceutike dhe kozmetike në asistim të farmacistit	Merr pjesë në organizimin e procesit të prodhimeve farmaceutike dhe kozmetike Përcjell fazat teknologjike në prodhime farmaceutike dhe kozmetike Kryen operacionet mekanike Kryen operacionet e nxehta në procesin e prodhimit Kryen operacionet difuzive Kryen operacionet teknologjike të bashkimit
6	Organizon vendin e punës në laborator në sektorin e farmacisë	Merr pjesë në përgatitjen e hapësirës për punë në laboratorin e barnatores Përgatit mjetet dhe lëndët e para për analiza dhe shqyrtime

		Siguron ambalazhin, evidenton dhe etiketon materialet e përgatitura dhe te shqyrtuara
7	Shet barna dhe pajisje mjekësore	Ben shitjet e ilaçeve që nuk kanë substanca medicinale me ndikim të fortë dhe shumë të fortë dhe nuk përmbajnë narkotikë, por që mund të jepen pa recetë të mjekut Ben shitjet e përgatitjeve (preparateve) galenike, dietike dhe kozmetike, mallra sanitare, mallra gome sanitare si dhe pajisje mjekësore
8	Komunikimi dhe bashkëpunimi me të tjerët	Bashkëpunon me ekipin mjekësor dhe pacientët në zbatimin e kujdesit dhe procedurave farmaceutike brenda kompetencave të tij. Zhvillon etikën në përputhje me Kodin e punonjësve Farmaceutikë Jep këshilla dhe njofton pacientin dhe familjarët për kujdesin shëndetësor, terapinë dhe procedurat e vetëkontrollit. Komunikon me pacientet, familjarët dhe komunitetin
9	Punët administrative dhe dokumentimi në procesin e punës	Merr pjesë në punët administrative në të gjitha proceset e punës Kontrollon dhe verifikon dokumentacionin në procesin e prodhimit Kryen analizën e recetave sipas llojeve të shërbimit Kryen llogaritjet e shërbimit shëndetësor Merr pjesë në dokumentimin administrativ të prodhimit, rezultatet e analizave, të kontrollit në industrinë farmaceutike
10	Punët komerciale dhe financiare	Kryen pranimin cilësor dhe sasior të mallrave në depo Angazhohet dhe kujdeset për trajtimin e duhur të mallrave (ilacet dhe substancat medicinale) Merr pjesë në punët e afarizmit të mallrave
11	Edukimi dhe zhvillimi në profesion	Merr pjesë në edukimin shëndetësor të pacientëve dhe të tjerëve Vazhdimisht dhe gjatë tërë jetës arsimohet në profesion Njofton pacientin dhe jep këshilla rreth terapisë me barna. Merr pjesë në seminare dhe kongrese të punëtorëve shëndetësorë në lëmin e farmacisë Njoftohet me risit dhe zbaton njohuritë dhe aftësitë e reja në fushën e farmacisë
12	Sigurimi i cilësisë në punë	Krijon mjedise të sigurta për zbatimin efektiv të cilësisë në punë si parim të suksesit të institucionit ku punon Kujdeset për saktësinë e pajisjeve, inventarit dhe eviton te metat e pa rregullsisë Njeh modelet evropiane të cilësisë (standardet) në farmaci Përdor tregues për të vlerësuar cilësinë e shërbimit

		Zhvillon marrëdhënien e shëndoshë në mes të personelit shëndetësor dhe pacientit Ruan sekretin profesional dhe respekton besimin dhe konfidencialitetin e pacientit dhe të familjareve të tij.
13	Ruajtja e shëndetit dhe mjedisit në vendin e punës	Punon për të ruajtur veten dhe të tjerët në vendin e punës Zbaton procedurat për mbrojtjen shëndetësore dhe ruajtjen e mjedisit Bën klasifikimin e mbetjeve mjekësore dhe sistemon paketimet dhe materialet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit Informon udhëheqesin për devijime të rëndësishme nga aspekti i sigurisë në punë

Definicioni i funksionit 1: Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punës

Ky funksion ka të bëjë me Organizimin dhe planifikimin e punëve dhe detyrave të Teknikut të farmacisë dhe atë; në analizën e procedurave profesionale të punëve dhe detyrave, në planifikimin dhe organizimin e punës në sektorin e farmacisë në prodhimin e barnave, në barnatore në shitje dhe në laborator në shqyrtimin dhe analizën e tyre. Gjatë ushtrimit të këtij funksioni ai mbledhë të dhëna për hartimin e planit, vendosjen e prioriteteve, gjendjen e materialit, mjeteve, pajisjeve dhe aparateve. Ben planifikimin e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve sanitare sipas kërkesës.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e përformancës	Njohuritë e nevojshme për të përformuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Analizon procedurat profesionale të punëve dhe detyrave	Kontribuon në procesin e analizimit të punëve dhe detyrave të sektorit të farmacisë Mbledh dhe klasifikon të dhëna për produkte dhe pajisje medicinale bazuar në planet, kapacitetin dhe shkallën e urgjencës	Njohuri për metodat , mjetet dhe teknikat të zbatuara në procesin e punës profesionale në farmaci Njohuri të duhura për produkte dhe pajisje medicinale	Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat farmaceutike Aftësi për përcaktimin e prioriteteve. Operator i mirë në përdorimin e kompjuterit Komunikon në mënyrë profesionale	Bashkëpunues i mirë Aftësi menaxheriale Komunikues i mirë
Merr pjesë në planifikimin, programimin dhe organizimin e punëve dhe detyrave	Kontribuon në procesin e planifikimit, programimit dhe organizimin e punëve dhe detyrave rreth produkteve farmaceutike dhe pajisjeve medicinale	Njohuri të mjaftueshme të planifikimit dhe programimit të punëve dhe detyrave në sektorin farmaceutik	Aftësi në përcaktimin e punëve dhe detyrave Aftësi për të punuar në grup. Shkathtësi në menaxhimin e kohës. Tregon aftësi për të planifikuar mënyrë të pavarur	Komunikues i mirë, I arsyeshëm dhe Tolerant Bashkëpunues i mirë Aftësi menaxheriale, Fleksibil

Kushtet e realizimit të funksionit:

Materialet dhe mjetet e punës: Vend pune ne sektorin e farmacisë ose ne shkollë dhomë mësimi, te kompletuar me materiale dhe mjete didaktike dhe përshkruese dhe katalogje të mjeteve,aparateve dhe paisjeve të ndryshme farmaceutike, tavolina pune, kompjuter ose llap-top personal, karrige lëvizëse, letër, laps, gomë , tabele , pano etj.

Kërkesat e vlerësimit:

Vlerësimet e rekomanduara për këtë standard janë:

Testimi i njohurive (me shkrim apo me gojë) përfshirë njohuritë mbi informatat faktike, procedurat e punës, të kuptuarit e principeve, çështjet që kanë të bëjnë me transferimin e kompetencave në rrethana dhe kontekste të ndryshme.

Vlerësimi praktik, formular i dëshmimeve për punën e nxënësve ne planifikim (dokumente të ndryshme në word, Excel, power point, letra biznesi, plan biznesi i thjeshtë, ose ndonjë pune tjetër që mund të jetë rezultat i definuar në module).

Evidenca e performancës: Evidenca se nxënësi ka aftësi ti kryej te gjitha punët dhe detyrat qe kanë te bëjnë me analizën e procedurave profesionale te punëve dhe detyrave, ne planifikimin dhe organizimin e punës ne sektorin e farmacisë ne prodhimin e barnave, ne barnatore ne shitje dhe ne laborator ne shqyrtimin dhe analizën e tyre.

Definicioni i funksionit 2: Përgatitja e vendit të punës

Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e vendit të punës; ne sigurimin e kushteve hapësinore, sistemimin dhe përgatitjen e materialeve, mjetet dhe pajisjet për prodhimin e barnave nën mbikëqyrjen e farmacistit, kontrollimin e saktësinë të mjeteve, pajisjeve, aksesorëve, pastrimin mekanik, dezinfektimin dhe sterilizimin e pajisjeve dhe instrumenteve në përputhje me standardet ekzistuese dhe ruajtjen e mjedisit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e përformancës	Njohuritë e nevojshme për të përformuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Merr pjesë në sigurimin e kushteve hapësinore	Përgatitë vendin e punës në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë Mirëmban higjienën, mikroklimën e favorshme (ajrosjen) Monitoron hapësirat punuese dhe eviton shkaktarët e rrezikut	Din të përshkruan mënyrën e përgatitjes së vendit të punës dhe respektimin e rregullave të sigurisë në punë Shpjegon mënyrën e përdorimit të masave të sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit	Shkathtësi organizative Aftësi të menaxhimit	Punon i pavarur Fleksibil dhe kreativ Bashkëpunon dhe punon në grupe
Përgatit aparaturën dhe aksesorëve për prodhimin e barnave nën mbikëqyrjen e farmacistit	Identifikon gjendjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës dhe kontribuon në përgatitjen e tyre Verifikon rregullsinë e pajisjeve, substancave mjekësore, ilaçeve, materialeve ndihmëse dhe paketimin e tyre	Njohuri për mënyrën e klasifikimit të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve Njohuri për furnizimin e materialeve të nevojshme për punë dhe përzgjedhjen e tyre. Përshkruan mënyrat e mirëmbajtjes të pajisjeve dhe veglave të punës	Shkathtësi në menaxhimin e materialeve, mjeteve dhe pasjeve sanitare. Shkathtësi në punë	Menaxhues i mirë, I arsyeshëm Fleksibil I shkathtë dhe preciz

		Tregon njohuri për mënyrën e përdorimit të veglave dhe pajisjeve për punë		
Përgatitja dhe monitorimi i punës sterile	Ndërmerr masa për parandalimin e përhapjes së infeksionit dhe kryen dezinfektimin e hapësirës dhe mjeteve të punës sipas nevojës Siguron kushtet e nevojshme higjienike, mikrobiologjike dhe klimatike për prodhimin dhe punimin e preparateve treguesve farmaceutikë, kozmetikë, reagentë	Njohuri për përgatitjen e pajisjeve dhe materialet për dezinfektim dhe sterilizim Njohuri për të gjitha format e dezinfektimit-sterilizimit dhe zbatimin e tyre (mekanike, fizike dhe kimike) Njohuri për mikroorganizmat patogjen dhe jo patogjen Njohuri për kontrollin e dezinfektimit (Kontrolli fiziko-kimik dhe kontrolli biologjik) Njeh protokollat e mirëmbajtjes dhe kontrollin dhe sigurisë gjatë dezinfektimit-sterilizimit	Njohës i mirë i procedurave dhe standardeve për dezinfektim dhe sterilizim Njohës i mirë i vetive të dezinfektimit dhe materialit sterilizues	Arritja në njohjen e procedurave të punëve dhe detyrave profesionale Operativ i mirë në punë I shkathët Aftësi për të respektuar rregullat për siguri në punë Menaxhues i mirë i kohës

Kushtet e realizimit të funksionit:

Materialet dhe mjetet e punës: Vend pune në sektorin e prodhimit, laborator apo barnatore të pajisur me të gjitha mjetet dhe materialet e nevojshme për punë, procedura pune, mjete dezinfektuese, aparate për sterilizimin e aparaturave dhe aksesoreve për prodhimin e barnave

Kërkesat e vlerësimit:

Vlerësimet e rekomanduara për këtë standard janë:

Testimi i njohurive (me shkrim apo me gojë) përfshirë njohuritë mbi informatat faktike, procedurat e punës, të kuptuarit e principeve, çështjet që kanë të bëjnë me transferimin e kompetencave në rrethana dhe kontekste të ndryshme.

Vlerësimi praktik, formular i dëshmimeve për punën e nxënësve në organizimin e vendit të punës (dokumente të ndryshme në word, Excel, power point ose ndonjë punë tjetër që mund të jetë rezultat i definuar në module).

Evidenca e performancës: Evidenca se nxënësi ka bërë përgatitjen dhe organizimin e vendit të punës se tij në vende reale të punës në shkollë apo institucion shëndetësor.

Definicioni i funksionit 3: Pranon dhe deponon barna dhe substanca farmaceutike në barnatore dhe depo farmaceutike

Ky funksion ka të bëjë me kontrollin, pranimin cilësor e sasior , deponimin dhe evidentimin e lëndes së parë, substancave farmaceutike, substancave ndihmëse, barnave, drogës, materialit sanitar, ambalazhit, etj. si dhe klasifikimin , paketimin, vendosje të veçantë të paketimeve të tipizuara dhe preparateve galenike dhe dërgimin e tyre nga depoja prodhuese ne depo qarkulluese me shumicë. Kujdes për manipulim të rregullt me barnat dhe substancat farmaceutike dhe për ruajtjen nga dëmtimi e prishja.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e përformancës	Njohuritë e nevojshme për të përformuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Merr pjesë në pranimin cilësor dhe sasior te lëndes së parë, substancave farmaceutike, substancave ndihmëse, barnave, drogës, materialit sanitar, ambalazhit, etj. dhe kryen deponimin e tyre	Ben pranimin e lëndes së parë, substancave farmaceutike, barnave ambalazhit materieve sanitare et, Evidenton kohën e pranimit të lëndës së parë Kontrollon lëndën e parë në mënyrë specifike para se të përcillet për në depo (merr mostrat dhe i dërgon ne laborator për verifikim te cilësisë) Kryen pranimin e mallit sipas procedurës pas rezultatit nga laboratori Raporton me kohë për çdo problem rreth pranimit cilësor tw mallit te menaxheri i depos	Njohuri të nevojshme për materialin dhe mjetet sanitare Njohuri baze për financa dhe kontabilitet Njohuri mbi organizimin e depove Njohuri rreth karakteristikave të përgjithshme për manipulimin me lëndët e para Të njohë format e kontrollit që realizohen para deponimit të tyre Njohuri rreth problemeve që mund të dalin gjatë punës me lëndët e para me qëllim që ato të raportohen dhe përmirësohen Identifikimi i materialeve që përdoren në farmaci Njohuri për mënyrat e pranimit dhe ruajtjes së pajisjeve mjekësore	Shkathtësi në llogaritjen e hyrjeve dhe daljeve. Aftësi për punë në grup Operator i mirë në përdorimin e kompjuterit. Tregon zotesi ne zgjidhjen e problemeve në konsultë me farmacistin;	Fleksibil I arsyeshëm Bashkëpunues i mirë Komunikon në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që e ben I përshtatshëm për punë ekipore;

Kontrollon dhe evidenton barnat, drogat, substancat shëruese dhe ndihmëse , ambalazhin dhe materialin sanitar.	Evidenton rezervat e barnave , përgatesave galenike , materialit sanitar, mjeteve të higjienës etj. Evidenton afatin e qëndrueshmërisë së barnave , drogës dhe substancave si dhe ndryshimin e çmimeve Rivendos rezervat e barnave për kushtet e veçanta	Njohuri të nevojshme për materialin dhe mjetet sanitare Njohuri baze për financa dhe kontabilitet Njohuri mbi organizimin e depove	Shkathtësi në llogaritjen e hyrjeve dhe daljeve. Aftësi për punë në grup Operator i mirë në përdorimin e kompjuterit.	Fleksibil I arsyeshëm Bashkëpunues i mirë Komunikon në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që e bën I përshtatshëm për punë ekipore;
Selekton (bën renditjen) e barnave , drogat, substancat farmaceutike, preparatet kozmetike sipas radhitjes alfabetike, veçorive (veprimet farmakologjik), gjendjes agregate (konsistencës) , mënyrës së aplikimit dhe destinimit	Bën vendosje të veçantë të paketimeve të tipizuara dhe preparateve galenike Paketon dhe dërgon barnat ,drogat, kemikatet nga depo qarkullues me shumicë Kujdeset për manipulim të rregulltë më barnat dhe substancat farmaceutike Kontribuon në ruajtjen nga dëmtimi dhe prishja	Njohuri të nevojshme për materialin dhe mjetet sanitare Njohuri baze për financa dhe kontabilitet Njohuri mbi organizimin e depove	Shkathtësi në llogaritjen e hyrjeve dhe daljeve. Aftësi për punë në grup Operator i mirë në përdorimin e kompjuterit.	Fleksibil I arsyeshëm Bashkëpunues i mirë Komunikon në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që e bën I përshtatshëm për punë ekipore;

Kushtet e realizimit të funksionit:

Materialet dhe mjetet e punës: Vend pune ne sektorin e prodhimit, laborator, ose barnatore te pajisur me te gjitha mjetet dhe materialet e nevojshme për punë, dokumentacion, mjete dhe pajisje për punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Vlerësimet e rekomanduara për këtë standard janë:

Testimi i njohurive (me shkrim apo me gojë); Duke përfshirë njohuritë mbi informatat faktike, procedurat e punës, të kuptuarit e principeve, çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin, pranimin cilësor e sasior, deponimin dhe evidentimin e lëndes se parë, substancave farmaceutike, substancave ndihmëse, barnave, drogës, materialit sanitar, ambalazhit, etj. si dhe klasifikimin , paketimin, vendosje të veçantë të paketimeve të tipizuara dhe preparateve galenike dhe dërgimin e tyre nga depoja prodhuese ne depo qarkulluese me shumicë. Kujdes për manipulim të rregullt më barnat dhe substancat farmaceutike dhe ruajtjen nga dëmtimi e prishja.

Vlerësimi praktik; Formular i dëshmime për punën e nxënësve ne pranimin dhe deponimin e barnave dhe substancave farmaceutike në barnatore dhe depo farmaceutike (dokumente të ndryshme te punuara në Word, Excel, Power Point ose ndonjë pune tjetër që mund të jetë rezultat i definuar në module).

Evidenca e performancës: Evidenca se nxënësi ka treguar aftësi ne kryerjen e procedura ne pranimin dhe deponimin e barnave dhe substancave farmaceutike në barnatore dhe depo farmaceutike në të gjitha proceset e punës në vende reale të punës.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se nxënësi ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkruara më lart

Definicioni i funksionit 4: Përgatit barna magjistrale dhe përgatesa galenike

Ky funksion ka të bëjë me mbikëqyrjen e procesit teknologjik të përfitimit të formave të lëngëta, formave të buta, gjysme të ngurta dhe të ngurta si dhe përfitimin e tyre nëpërmes ecurive farmaceutike-teknologjike duke përgatit vendin e punës, përzgjedhjen e materialit, përzgjedhjen e enëve kimike për përfitimin e formave, kontrollin e cilësisë, ambalazhin, paketimin dhe etiketimin e tyre.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e përformancës	Njohuritë e nevojshme për të përformuar funksionin	Shkathhtësitë	Shkathhtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave të lëngëta farmaceutike	Përgatitë vendin e punës për përfitimin e formave farmaceutike të lëngëta Përzgjedhë enët kimike që nevojiten për përfitimin e formave farmaceutike të lëngëta Përgatitë ujin e distiluar dhe ridistiluar Përfiton tretësira ujore, alkoolike dhe vajore duke zbatuar procesin e tretjes; Kryen kontrollin e cilësisë së formave farmaceutike të lëngëta Ambalazhon format farmaceutike të lëngëta Etiketeton dhe ruan format farmaceutike të lëngëta	Të njohë të gjitha format farmaceutike të lëngëta dhe karakteristikat e secilës prej tyre para përgatitjes së vendit të punës Njohuri të nevojshme për enët kimike që nevojiten për përfitimin e formave farmaceutike të lëngëta Njohuri të mira rreth procesit të tretjes dhe për karakteristikat fiziko-kimike të tretësirave ujore, alkoolike dhe vajore Njohuri rreth formave të realizimit të kontrollit të cilësisë së formave farmaceutike të lëngëta Njohuri rreth formave dhe materialeve të ambalazhimit të formave të lëngëta farmaceutike në varësi të tretësit dhe qëndrueshmërisë së lëndëve vepruese nga faktorët e jashtëm Njohuri rreth formave të etiketimit në varësi nga mënyra e aplikimit apo fortësia e lëndëve vepruese Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së formave të lëngëta farmaceutike në vende	Shkathhtësi në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathhtësi në menaxhimin e kohë Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Aftësi të mira menaxhimi. Tregon aftësi në dallimin e karakteristikave dhe llojeve të substancave themelore që përdoren në prodhim.	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur në kryerjen e detyrave. Operator i mirë në përdorimin e programeve për ruajtjen e të dhënave Përgjegjësi në punën Aftësi për të planifikuar, zbatuar dhe kontrolluar në mënyrë të pavarur;

		të përshtatshme		
Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave të buta farmaceutike	Përgatitë vendin e punës për përfitimin e formave gjysmë të ngurta farmaceutike Përzgjedhë enët që nevojiten për përfitimin e formave gjysmë të ngurta farmaceutike Zbaton procesin e pluhurizimit Përfiton forma farmaceutike gjysmë të ngurta Kryen e kontrollin e cilësisë së formave gjysmë të ngurta farmaceutike Ambalazhon forma gjysmë të ngurta farmaceutike Etiketeton dhe ruan format gjysmë të ngurta farmaceutike	Të njohë të gjitha format farmaceutike të buta dhe karakteristikat e secilës prej tyre para përgatitjes së vendit të punës Njohuri të nevojshme për enët kimike që nevojiten për përfitimin e formave farmaceutike gjysmë të ngurta Njohuri të mira rreth procesit të pluhurizimit dhe për format se si realizohet ky proces çoftë në laboratorin magjstral apo galen Njohuri rreth formave të realizimit final të formave farmaceutike të buta si dhe dukja e tyre përfundimtare Njohuri rreth mënyrave adekuate dhe procedurave për kryerjen e kontrollit të cilësisë së formës farmaceutike gjysmë të ngurta Njohuri rreth formave dhe materialeve të ambalazhimit të formave gjysmë të ngurta farmaceutike në varësi të tretësit dhe qëndrueshmërisë së lëndëve vepruese nga faktorët e jashtëm Njohuri rreth formave të etiketimit në varësi nga mënyra e aplikimit apo fortësia e lëndëve vepruese Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së formave gjysmë të ngurta farmaceutike në vende të përshtatshme	Shkathtësi në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathtësi në menaxhimin e kohës Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Aftësi të mira menaxhimi të proceseve teknologjike të prodhimit Zbaton në mënyrë profesionale metodat e kontrollit gjatë procesit të prodhimit	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur në kryerjen e detyrave. Operator i mirë në përdorimin e programeve për ruajtjen e të dhënave Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi personale; I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë

Mbikëqyr procesin teknologjik të përfitimit të formave gjysmë të ngurta dhe të ngurta farmaceutike	Përgatitë vendin të punës për përfitimin e formave të ngurta farmaceutike Përzgjedhë enët kimike që nevojiten për përfitimin e formave të ngurta farmaceutike Zbaton procesin e pluhurizimit Përdorë lëndë vepruese që hyjnë ne përbërjen e formave të ngurta farmaceutike Përfiton format e ngurta farmaceutike Kryen kontrollin e cilësisë së formave të ngurta farmaceutike Ambalazhon format e ngurta farmaceutike Etiketon dhe ruan format e ngurta farmaceutike	Të njohë të gjitha format farmaceutike të ngurta dhe karakteristikat e secilës prej tyre para përgatitjes së vendit të punës Njohuri të nevojshme për enët kimike që nevojiten për përfitimin e formave farmaceutike të ngurta Njohuri të mira rreth procesit të pluhurizimit dhe për format se si realizohet ky proces çoftë në laboratorin magjstral apo galen Njohuri rreth lëndëve vepruese që hyjnë në punimin e formave farmaceutike të ngurta dhe karakteristikat e tyre fiziko-kimike Njohuri rreth formave të realizimit final të formave farmaceutike të ngurta si dhe forma e tyre përfundimtare Njohuri rreth mënyrave adekuate dhe procedurave për kryerjen e kontrollit të cilësisë së formave farmaceutike të ngurta Njohuri rreth formave dhe materialeve të ambalazhimit të formave të ngurta farmaceutike në varësi të tretësit dhe qëndrueshmërisë së lëndëve vepruese nga faktorët e jashtëm Njohuri rreth formave të etiketimit në varësi nga mënyra e aplikimit apo fortësia e lëndëve vepruese Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së	Shkathësi ne përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathësi ne menaxhimin e kohë Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike I dallon lëndët e para që përdoren në laboratorin e galenikes Zbaton dhe kontrollon drejt procedurat e prodhimit Tregon njohuri për Pharmacopenë; tregon shkathtesin ne përdorimin me mjetet e punës Konsultohet në vazhdimësi me farmacistin përgjegjës; Tregon sjellje profesionale Aftësi të mira menaxhimi.	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave. Operator i mirë në përdorimin e programeve për ruajtjen e të dhënave Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi personale; I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë
---	---	--	--	---

		formave të ngurta farmaceutike në vende të përshtatshme		
Merr pjese ne prodhimin e barnave magjistrale dhe galenike të cilat në vete nuk përmbajnë substance të ndikimit të fortë dhe shumë të fortë dhe narkotikë	Punon dhe paketon reagjensat klinik , preparatet te tipizuara, indikatorët Merr pjesë në përpunimin e bimëve mjekësore Merr pjesë në përgatitjen e preparateve galenike Përgatitë, sterilizon dhe kontrollon tretësit e përgatesave parenterale Merr pjesë në kontrollin kimik të tretësve të përgatesave parenterale Paketon barnat magjistrale në ambalazhin përkatës dhe e vendosë etiketën Pastron inventarin laboratorik	Ka njohuri mbi matjet të ndryshme të lëndëve të para qe përdoren ne procesin e prodhimit I njeh dhe dallon mjetet e punës qe përdoren sipas procesit teknologjik ambalazhimit, etiketimin Asiston farmacistin gjatë përzierjes se preparateve galenike Njohuri mbi procedurat dhe kriteret e sterilizimit Përgatit kutitë adekuate për ambalazhim; Bën paketimin final; Bën distilimin e ujit.	Shkathtësi ne përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathtësi ne menaxhimin e kohë Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Aftësi të mira menaxhimi. Pastron vendin e punës, Kryen sterilizimin e mjeteve te punës sipas nevojës	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave. Operator i mirë në përdorimin e programeve për ruajtjen e të dhënave Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi personale; I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë

Kushtet e realizimit të funksionit:

Materialet dhe mjetet e punës: Vend pune ne sektorin e prodhimit, laborator, ose barnatore te pajisur me te gjitha mjetet dhe materialet e nevojshme për punë, dokumentacion, mjete dhe pajisje për punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Vlerësimet e rekomanduara për këtë standard janë:

Testimi i njohurive (me shkrim apo me gojë): Duke përfshirë njohuritë mbi informatat faktike, procedurat e punës, të kuptuarit e principeve, çështjet që kanë të bëjnë me përgatitjen e barnave magjistrale dhe përgatesave galenike në të gjitha proceset e punës.

Vlerësimi praktik, formular i dëshmive për punën e nxënësve në përgatitjen e barnave magjistrale dhe përgatesave galenike në të gjitha proceset e punës dhe dokumentimin e duhur (dokumente të ndryshme të punuara në Word, Excel, Power Point ose ndonjë punë tjetër që mund të jetë rezultat i definuar në module).

Evidenca e performancës: Evidenca se nxënësi ka kryer procedura në përgatitjen e barnave magjistrale dhe përgatesave galenike në të gjitha proceset e punës në vende reale të punës në institucion shëndetësor.

Definicioni i funksionit 5: Kryen dhe mbikëqyrë fazat teknologjike në prodhimtarinë farmaceutike dhe kozmetike ne asistim te farmacistit

Ky funksion ka të bëj me kryerjen e punëve dhe detyrave te teknikut te farmacisë ne organizimin dhe përcjelljen e procesit te prodhimit ne prodhimtarin farmaceutike dhe kozmetike sipas udhëzimeve, kërkesave cilësore dhe masave higjeno-teknologjike, ne kryerjen e operacioneve mekanike, difuzive, te nxehta te bashkimit dhe formimit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e përformancës	Njohuritë e nevojshme për të përformuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Merr pjese ne organizimin e procesit te prodhimeve farmaceutike dhe kozmetike	I përcakton punëtoret në linjat e prodhuese dhe ju ndan detyrat e punës ne baze të planeve ditore, kapacitetet dhe normativave te prodhimit Kryen identifikimin e lëndës së parë dhe regjistron numrin e kontrollit nga paketimi origjinal në listën e duhur të dokumentacionit të prodhimit Kontrollon hyrjen e materialit riprodhues në depon doracake dhe kryen kontrollin organo leptik Kontrollon saktësinë e peshores dhe regjistron të dhënat në listën e evidencës të kalibrimit	Njeh të gjitha procedurat e përgatitjes së vendit të punës për organizimin e procesit te prodhimeve farmaceutike dhe kozmetike Njohuri të mira rreth vetive dhe karakteristikave te lendes se par Njohuri rreth mënyrave adekuate dhe procedurave për kryerjen e kontrollit të cilësisë së formave farmaceutike të ngurta Njohuri rreth formave dhe materialeve të ambalazhimit të formave të farmaceutike në varësi të destinimit Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së produkteve farmaceutike në vende të përshtatshme Ka njohuri mbi matjet të ndryshme të lëndëve të para qe përdoren ne procesin e prodhimit I njeh dhe dallon mjetet e punës qe përdoren sipas procesit teknologjik te	Shkathtësi ne menaxhimin e kohë Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar proceduarat e proceseve teknologjike Aftësi të mira menaxhimi ne organizimin e punës ne prodhim Pastron dhe rregullon vendin e punës, Rendit dhe sistemon materialin dhe mjetet e punës sipas procesit te prodhimit	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave. Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi personale; I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë

	te peshores Ben matjen e substancave aktive dhe ndihmëse dhe konfirmon me nënshkrim saktësinë e tyre në listën e punës	prodhimit, ambalazhimit, etiketimit etj. Përgatit kutitë adekuate për ambalazhim;		
Përcjell fazat teknologjike në prodhime farmaceutike dhe kozmetike	Përgatitë vendin e punës për prodhime farmaceutike dhe kozmetike Përzgjedhë materialet dhe mjetet e punës Përcjell fazat teknologjike në prodhimin farmaceutik dhe kozmetik sipas udhëzimeve, kërkesave cilësore dhe masave higjeno-teknologjike Mbikëqyr procesin e homogjenizimit, suspensionin, emulsifikimin, tretjen, granulimin, tabletimin, kullimin, kapsulimin, bluarjen, mbjelljen, dozimin, paketimin etj) Kryen kontrollin e cilësisë së produkteve	Njih të gjitha procedurat e procesit të prodhimeve farmaceutike dhe kozmetike Njohuri të mira rreth vetive dhe karakteristikave të lëndës së parë Njohuri rreth mënyrave adekuate dhe procedurave për kryerjen e kontrollit të cilësisë së produkteve Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së produkteve farmaceutike në vende të përshtatshme Ka njohuri mbi matjet të ndryshme të lëndëve të para që përdoren në procesin e prodhimit I njih dhe dallon mjetet e punës që përdoren sipas procesit teknologjik të prodhimit, ambalazhimit, etiketimit etj. Përgatit kutitë materialet adekuate për ambalazhim; Bën paketimin final;	Shkathtësi në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve prodhuese Shkathtësi në menaxhimin e kohës Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Zbaton dhe kontrollon drejt procedurat e prodhimit Tregon njohuri dhe shkathtësi në përdorimin e mjeteve të punës Konsultohet në vazhdimësi me farmacistin përgjegjës; Tregon sjellje profesionale	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur në kryerjen e detyrave. Përgjegjës në punë Fleksibil Efikas Aftësi personale; I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë

	Ambalazhon dhe etiketon produktet			
Kryen operacionet mekanike ne farmaci	Përgatitë vendin e punës për prodhime farmaceutike dhe kozmetike Përzgjedhë materialet dhe mjetet e punës Kontribuon dhe mbikëqyre proceset teknologjike ne operacionet mekanike te prodhimit Kryen kontrollin e cilësisë se produkteve Ambalazhon dhe etiketon produktet	Njih të gjitha operacionet e proceseve mekanike te prodhimeve farmaceutike dhe kozmetike Njohuri të mira rreth vetive dhe karakteristikave te lendes se parë Njohuri rreth mënyrave adekuate dhe procedurave për kryerjen e kontrollit të cilësisë së produkteve Njohuri rreth kushteve të ruajtjes së produkteve farmaceutike në vende të përshtatshme Ka njohuri mbi matjet të ndryshme të lëndëve të para qe përdoren ne procesin e prodhimit I njeh dhe dallon mjetet e punës qe përdoren sipas procesit teknologjik te prodhimit, ambalazhimit, etiketimit etj. Përgatit kutitë adekuate për ambalazhim; Bën paketimin final	Shkathtësi ne menaxhimin e kohës Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Zbaton dhe kontrollon drejt procedurat e prodhimit Tregon njohuri ne shkathtësi ne përdorimin me mjeteve te punës Konsultohet në vazhdimësi me farmacistin përgjegjës; Tregon sjellje profesionale	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Bashkëpunues. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave. Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi profesionale I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë
Kryen operacionet e nxehta ne procesin e prodhimit ne farmaci	Përgatitë vendin e punës për prodhime farmaceutike dhe kozmetike nëpërmes operacioneve te nxehta	Të njohë operacionet që kryhen me anë të nxehtësisë, si zierjen, avullimin, ftohjen, kondensimin; Dallon aparaturat dhe enët që përdoren për zierje, avullim, ftohje dhe kondensim	Shkathtësi ne përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathtësi ne menaxhimin e kohës	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave.

	Përzgjedhë materialet dhe mjetet e punës Kontribuon dhe mbikëqyre proceset teknologjike ne operacionet e nxehta ne procesin e prodhimit Kryen kontrollin e cilësisë se produkteve Ambalazhon dhe etiketon produktet	Të njohë operacionin e destilimit; Shpjegojnë rëndësinë e destilimit Të njohë metodat e sterilizimit dhe aparaturat për sterilizim; Dallojnë metodat aseptike Përgatit kutitë adekuate për ambalazhim; Bën paketimin final	Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike Zbaton dhe kontrollon drejt procedurat e prodhimit Konsultohet në vazhdimësi me farmacistin përgjegjës; Tregon sjellje profesionale	Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi profesionale I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë
Kryen operacionet difuzive	Përgatitë vendin e punës për zhvillimin e procesit te prodhimit nëpërmes operacioneve difuzive Përzgjedhë materialet dhe mjetet e punës Kontribuon dhe mbikëqyre proceset teknologjike ne operacionet difuzive ne procesin e prodhimit Kryen kontrollin e cilësisë se produkteve Ambalazhon dhe etiketon produktet	Njohuri mbi operacionet difuzive që kryhen ne procesin e prodhimit te produkteve farmaceutike Dallon operacionet difuzive siç janë: tharja, absorbimi, kristalizimi Dallon aparaturat dhe enët që përdoren gjatë zhvillimit te operacioneve difuzive Të njohë metodat e sterilizimit dhe aparaturat për sterilizim; Dallojnë metodat aseptike Përgatit kutitë adekuate për ambalazhim; Bën paketimin final Njëhë dhe	Shkathtësi ne përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve Shkathtësi ne menaxhimin e kohës Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar procedurat e proceseve teknologjike difuzive Zbaton dhe kontrollon drejt procedurat e prodhimit Konsultohet në vazhdimësi me farmacistin përgjegjës; Tregon sjellje profesionale	Komunikues i mirë. Interpretues i mirë. Punon i pavarur ne kryerjen e detyrave. Përgjegjësi në punë Fleksibil Efikas Aftësi profesionale I përshtatshëm për punë ekipore Respekton hierarkinë në punë

